
RREGULLORE NR. 2003/24

**PËR SHPALLJEN E LIGJIT TË MIRATUAR NGA KUVENDI I KOSOVËS
MBI RRUGËT**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë sipas Rezolutës 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Në përputhje me nenet 8.1. (a), 9.1.44 dhe 9.1.45 të Kornizës Kushtetuese të Vetëqeverisjes së Përkohshme (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9),

Duke marrë parasysh njoftimet zyrtare të Kryetarit të Kuvendit të Kosovës të datës 6 qershor 2003 lidhur me Ligjin mbi rrugët i miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 29 maj 2003,

Pa cenuar autoritetin e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm për garantimin e mbrojtjes së të drejtave dhe interesave të komuniteteve dhe administrimin e pronës publike, shtetërore dhe shoqërore në pajtim me pargarfët 8.1 (a) dhe (q) të Kornizës Kushtetuese të Vetëqeverisjes së Përkohshme,

Me anë të të kësaj shpall Ligjin mbi rrugët që i është bashkëngjitur kësaj Rregulloreje (Ligji nr. 2003/11) dhe hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij me ndryshimet vijuese:

- a) Termi “vendet fqinje” në nenin 2 zëvendësohet me “rajonet jashtë Kosovës” dhe
- b) Termi “qytetar(ë) në nenin 2 zëvendësohet me “banor(ë).

Këto ndryshime duhet të pasqyrohen në tekstin përfundimtar të ligjit.

Nënshkruar sot, më 27 qershor 2003.

Michael Steiner,
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm

LIGJI PËR RRUGËT

Kuvendi i Kosovës,

Duke u bazuar në Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2001/9 të 15 Majit Mbi Komizën Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë, veçanërisht nenet 5.1(h),5.7,9.1.26(a),9.3.3,dhe

Me qëllim të promovimit të zhvillimit të një rrjeti modern të rrugëve në Kosovë,duke siguruar që përmbajtja e rregullave të cilat ndikojnë në ndërtimin e rrugëve, mbrojtjen, mirëmbajtjen, qeverisjen, financimin dhe mbikëqyrjen e tyre të zhvillohen dhe zbatohen në përputhshmëri të plotë me përvojat më të mira ndërkombëtare,

Aprovon:

KREU I

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë ligj rregullohet pozita juridike e rrugëve publike, ndërtimi, mirëmbajtja e rrugëve, masat mbrojtëse, qeverisja, financimi dhe mbikëqyrja e rrugëve publike.

Neni 2

“Person i Autorizuar ” e ka kuptimin e një personi i cili autorizohet që të ndërmarrë veprime të caktuara në përputhje me atë që përcakton ky ligj;

“Rrugë” e ka kuptimin e një sipërfaqeje të tërë të ndonjë drejtimi të përcaktuar për komunikacion;

- “**Ndërtimi**” e ka kuptimin e ndërtimit ose rindërtimit të rrugës dhe bërjen e ndonjë pune tjetër të domosdoshme për ta vënë rrugën në gjendje të sigurtë për shfrytëzim nga automjetet, por nuk përfshinë mirëmbajtjen;
- “**Vlerësimi mbi efektet në mjedis**” e ka kuptimin e një studimi gjithëpërfshirës mbi efektet e mundshme të ndikimit të ndonjë zhvillimi të propozuar të rrugës në mjedis;
- “**Rrugë Lokale**” e ka kuptimin e rrugës publike zyrtarisht të kategorizuar si rrugë lokale, që lidhë hapësirat e banueshme brenda vendbanimeve të një komune;
- “**Mirëmbajtja**” e ka kuptimin e mbajtjes dhe riparimit të një rruge ose ndonjë pune tjetër të domosdoshme që ta mbaj rrugën në gjendje të mirë;
- “**Rrugë Magjistrale**” e ka kuptimin e rrugës publike zyrtarisht të kategorizuar si një rrugë magjistrale, që lidhë qytetet e mëdha dhe të cilat mund të shërbejnë si lidhje me shtetet fqinje;
- “**Ministria**” e ka kuptimin e Ministrisë së Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit;
- “**Komuna**” e ka kuptimin e përkufizimit të Komunës siç parashihet në Rregulloren të UNMIK -ut 2000/45;
- “**Rrugë Publike**” e ka kuptimin e rrugës magjistrale, regjionale, lokale dhe rrugës në vendbanime me të drejtë të drejtimit për komunikacion publik;
- “**Autoriteti i Rrugës Publike**” e ka kuptimin e autoritetit administrativ përkatës të emëruar nga Ministria për rrugë magjistrale dhe regjionale dhe Komuna për rrugë lokale dhe rrugë në vendbanime;
- “**Rrugë Regjionale**” e ka kuptimin e një rruge publike zyrtarisht të kategorizuar si një rrugë regjionale, që lidh dy e më tepër qytete të mëdha;
- “**Rrugë Lidhëse**” e ka kuptimin e një rruge që lidh stacionet hekurudhore, aeroportet, terminalët ose hapësirët e banimit me rrugët publike që është e njohur zyrtarisht nga Ministria si e tillë;
- “**Brez Mbrojtës Rrugor**” e ka kuptimin e hapësirës të përcaktuar nga Ministria anash rrugës, ku kufizimet në lidhje me shfrytëzimin e saj janë zbatuar me qëllim të përfshirjes të brezit rrugor dhe atij mbrojtës të rrugëve publike;
- “**Rrugë e Pakategorizuar**” e ka kuptimin e çdo rruge që nuk është rrugë publike, pronari i së cilës është një qytetar apo grup qytetarësh, dhe nuk është nën përgjegjësinë e Ministrisë, por e cila është jozyrtarisht e shfrytëzuar nga këmbësorët, automjetet dhe mjeteve tjera lëvizëse që lëvizin anash në hapësirën e pashënuar;
- “**Zonë Urbane**” e ka kuptimin e teritorit nën juridiksionin e Komunës kufijt e së cilës janë caktuar me shenja të rrugëve; dhe
- “**Peshat dhe Dimensionet**” e ka kuptimin e parametrave specifik në peshë, gjatësi, gjerësi dhe lartësi të automjeteve.

Rruga publike është për përdorim të përgjithshëm dhe sferë interesi për Kosovën.

KREU II

RRUGËT PUBLIKE

Neni 4

4.1. Rrugët publike kategorizohen në:

- a) Rrugë magjistrale
- b) Rrugë regjionale,
- c) Rrugë lokale dhe
- d) Rrugë në vendbanime.

4.2. Statusi i rrugëve magjistrale dhe regjionale nuk është i prekur (i goditur) kur këto rrugë kryqëzojnë hapësirët urbane.

Neni 5

5.1. Ministria është autoritet për rrugë publike magjistrale e regjionale.

5.2. Komuna është autoritet për rrugë publike lokale dhe ato në vendbanime.

5.3. Ministria mban një regjistër i cili përmbanë evidencën e të gjitha rrugëve publike.

5.4. Ministria është e obliguar të informoj Qeverinë për kryerjen e kategorizimit të rrugëve.

Neni 6

6.1. Ministria për rrugë magjistrale dhe regjionale dhe Komuna rrugë lokale mund:

- a) Të caktoj rrugë të veçanta për qëllime të veçanta.
- b) Të ndaj një klasë të veçantë të rrugëve në nënklasë.

6.2. Sipas shfrytzimit të tyre, rrugët publike mund të jenë të destinuara për pjesëmarrës në komunikacionin rrugor (për automjete motorike, bicikleta, këmbësorë dhe shfrytëzues të tjerë), ose vetëm për automjete motorike.

Neni 7

- 7.1. Ministria mund të kategorizoj cilën do rrugë publike ekzistuese ose ndonjë rrugë të propozuar publike si rrugë magjistrale ose si rrugë regjionale.
- 7.2. Komuna mund të kategorizojë ndonjë rrugë ekzistuese të pakategorizuar si rrugë lokale.
- 7.3. Ministria nxjerr akt të veçantë mbi kategorizimin e rrugëve në pajtim me nenin 4 të këtij ligji.

Neni 8

- 8.1. Ministria është përgjegjëse për menaxhim, mirëmbajtje dhe ndërtim të rrugëve magjistrale dhe regjionale, ndërsa Komuna është përgjegjëse për rrugët lokale dhe ato në vendbanime.
- 8.2. Komuna duhet të kërkoj këshilla nga Ministria për menaxhimin, mirëmbajtjen dhe ndërtimin e rrugëve lokale dhe atyre të vendbanimeve.
- 8.3. Ministria me akte të veçanta përcakton rregullat specifike dhe kompetencat e Departamentit të Infrastrukturës rrugore të Ministrisë dhe të Drejtorisë së rrugëve.

Neni 9

- 9.1. Komuna me kërkesë të Ministrisë bënë eksproprijimin e çfardo pjese të tokës, përrua, ujëra, kanal, gardh ose mur, marrja dhe përvetsimin i të cilave Ministria mendon se është e nevojshme për shfrytëzim, ndërtim, ose mirëmbajtjen e rrugëve magjistrale dhe regjionale.
- 9.2. Komuna bënë eksproprijimin e çfardo pjese të tokës, përrua, ujëra, kanal, gardh ose mur, marrja dhe përvetsimi i të cilave, është e nevojshme për shfrytëzim, ndërtim ose mirëmbajtjen e rrugëve lokale.
- 9.3. Kur Ministria ose Komuna duhet të eksproprijoj ndonjë pjesë të tokës, përrua, ujëra, kanal, gardh ose mur në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, atë duhet ta zbatoj në bazë të Ligjit mbi Eksproprijimin.

Neni 10

Mirëmbajtja dhe ndërtimi i rrugëve publike do të financohet nga përvetësimet e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës. Gjatë përcaktimit të shumave të përvetësimeve në fjalë, Kuvendi do të marrë parasysh si vijon”:

- a) tatimet mbi konsumimin e karburanteve
- b) tarifat e regjistrimit të automjeteve
- c) tarifat për përdorimin e rrugëve
- d) tarifat nga koncesionet
- e) donacionet për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve

Neni 11

Asnjë personi juridik ose fizik nuk i miratohet kërkesa për bartjen e pronësisë në rrugë publike ose ndaj një pjese të rrugës publike.

KREU III

MIRËMBAJTJA

Neni 12

Ministria nxjerr planin vjetor të mirëmbajtjes dimërore dhe verore për rrugët magjistrale dhe regjionale, ndërsa Komuna nxjerr planin vjetor të mirëmbajtjes dimërore dhe verore për rrugët lokale.

Neni 13

- 13.1. Ministria është përgjegjëse për mirëmbajtjen e shenjave të trafikut në rrugët magjistrale dhe regjionale, ndërsa Komuna është përgjegjëse për vendosjen e shenjave të trafikut në rrugët lokale.
- 13.2. Ministria është përgjegjëse për mirëmbajtjen e shenjave të trafikut në kryqëzimet e rrugëve magjistrale dhe regjionale me linjat e hekurudhës, ndërsa Komuna është përgjegjëse për mirëmbajtjen e shenjave të trafikut në kryqëzimet e rrugëve lokale me linjat e hekurudhës.

Neni 14

Ministria për rrugë magjistrale e regjionale, ndërsa komuna për rrugë lokale mund të lidhin kontrata me kompanitë e besueshme të cilat janë lëndë e legjislacionit për prokurim.

KREU IV

NDËRTIMI DHE RIKONSTRUKTIMI

Neni 15

Ministria nxjerr rregulla mbi kriteret teknike për ndërtimin dhe rekonstruktimin e rrugëve publike.

Neni 16

- 16.1. Ministria nxjerr planin vjetor të ndërtimit dhe të rekonstruktimit të rrugëve magjistrale dhe regjionale, ndërsa Komuna nxjerr planin vjetor të ndërtimit dhe rekonstruktimit të rrugëve lokale.
- 16.2. Komuna informon Ministrinë mbi programin vjetor të ndërtimit të rrugëve lokale.
- 16.3. Ministria koordinon programet e ndërtimit dhe rekonstruktimit për Autoritetet e rrugëve publike.

Neni 17

- 17.1. Komuna dhe pronarët e rrugëve të pakategorizuara informojnë Ministrinë lidhur me planin për ndërtim dhe lidhjet e rrugëve të tyre me rrugët magjistrale dhe regjionale.
- 17.2. Pronarët e rrugëve të pakategorizuara që dëshirojnë të kenë çasje në rrugë magjistrale ose regjionale jashtë hapësirëve urbane duhet të sigurojnë lejën nga Ministria.

Neni 18

Ministria për rrugë magjistrale dhe regjionale, dhe Komuna për rrugë lokale, cakton rregulla sipas standardeve për ndërtim dhe rekonstruktimit të rrugëve publike.

Neni 19

- 19.1. Ministria në bashkëpunim me Ministrinë për Ambient dhe Planifikim Hapësinor përgatitë një vlerësim mbi ndikimin në ambient për çfarëdo propozimi të zhvillimit të rrugës që ka të bëjë me ndërtimin e rrugës magjistrale ose regjionale.
- 19.2. Komuna në bashkëpunim me Ministrinë për Ambient dhe Planifikim Hapësinor përgatitë një vlerësim mbi ndikimin në ambient për çfarëdo propozimi të zhvillimit të rrugës që ka të bëjë me ndërtimin e rrugës lokale.
- 19.3. Vlerësimi i ndikimit në mjedis përgatitet në pajtim me procedurën e paraparë me Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit
- 19.4. Vlerësimi mbi ndikimin në ambient duhet të përmbaj, por nuk është i kufizuar në informacione të veçanta vijuese:
- a) një përshkrim të propozimit të ndërtimit të rrugës, duke përmbajtur informacione për pozitën, konstruksionin, masën, karakteristikat fizike dhe kriteret për përdorimin e tokës për ndërtim;
 - b) të dhënat e nevojshme për të identifikuar dhe vlerësuar efektet kryesore që propozimi i ndërtimit të rrugës mund të ketë ndaj ambientit;
 - c) një përshkrim të efekteve të mundshme të rëndësishme për ambientin lidhur me ndërtimin e rrugës së propozuar; dhe
 - f) ku janë identifikuar efekte të kundërta ndaj ambientit, përshkrimi i masave të parashikuara për të penguar, redukuar dhe nëse është e mundur mundshme për të rregulluar këto efekte.

19.5. Ministria në bashkëpunim me Ministrinë për Ambient dhe Planifikim Hapësinor përgatitë rregullat e detajzuara të një vlerësimi mbi ndikimin në ambient.

19.6. Rregullat mbi vlerësimin e ndikimit në ambient do t'i aprovoj Qeveria.

Neni 20

20.1. Ministria është përgjegjëse për vendosjen e shenjave të trafikut mbi rrugët e ndërtuara magjistrale dhe regjionale.

20.2. Komuna është përgjegjëse për vendosjen e shenjave të trafikut mbi rrugët e ndërtuara lokale.

20.3. Ministria dhe Komuna janë përgjegjëse për vendosjen e shenjave të trafikut që kanë lidhje me kryqëzimet e rrugëve publike me linjat hekurudhore, secila në fushën e kompetencave që kanë për llojin e caktuar të rrugëve.

KREU V

SHFRYTËZIMI I RRUGËVE

Neni 21

Kushdo që përdorë rrugën publike duhet të marrë të gjitha masat e arsyeshme që të shmangë:

- a) Lëndimin e çdo personi i cili përdorë rrugën publike,
- b) Dëmtimin e pronës së çdo personi, kur shfrytëzon rrugën publike dhe
- c) dëmtimin e rrugës .

Neni 22

22.1. Personi juridik ose fizik bën kundërvajtje nëse pa arsye dhe në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji:

- a) Bllokon një rrugë publike ose vendos ndonjë material në rrugë publike; ose
- b) Pengon, ndërpre, shkurton ose në mënyrë tjetër dëmton rrugën publike.

22.2. Kur gjykata shpall fajtor personin juridik ose fizik për shkelje sipas paragrafi 1 (a) dhe (b) të këtij neni ajo obligon atë që ta bëjë kthimin në gjendjen e mëparshme.

Neni 23

- 23.1. Derisa ndërtimi ose mirëmbajtja është duke vazhduar në rrugë publike, Autoriteti i rrugës publike mundet ta mbyllë për trafik, për çka duhet të vendosë shenjë të çartë në atë pjesë të rrugës publike në të cilën puna është në kryerje e sipër.
- 23.2. Personi që shfrytizon rrugën publike afër trafikut në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni e bën këtë në rrezikun e tij, ndërsa Autoriteti i rrugës publike nuk mbanë përgjegjësi për ndonjë dëmtim që rezulton nga shfrytëzimi i trafikut afër rrugës publike.
- 23.3. Kur rruga publike është mbyllur sipas këtij neni, asnjë person nuk mund të hyj ose udhëtoj nëpër rrugë publike përveç nëse ai ose ajo:
- a) Është i/e autorizuar nga Autoritetet e rrugës publike; dhe kur
 - b) Hyrjet ose udhëtimet në rrugë publike të cilat janë në funksion të detyrës lidhur me ndërtimin ose mirëmbajtjen e punës që është duke e kryer në atë rrugë publike.

Neni 24

Ministria nxjerr rregulla të veçanta lidhur me peshat dhe dimensionet e automjeteve të cilat shfrytëzojnë rrugët publike, duke përfshirë:

- a) Rregullat e veçanta për çdo kategori të automjeteve;
- b) Rregullat mbi mjetet kontrolluese për peshat e automjeteve;
- c) Dispozitat ndëshkuese për shkeljen e rregullave për peshat dhe dimensionet; dhe
- d) Lejen e automjeteve për transport të jashtëzakonshëm.

Neni 25

- 25.1. Pronari i automjetit me mbingarkesë i cili operon në rrugë publike kryen kundërvajtje dhe përgjigjet nëse vepron në kundërshtim me nenin 24 të këtij ligji.
- 25.2. Pronarët e automjeteve munden të tejkalojnë rregullat e përcaktuara për peshat dhe dimensionet vetëm nëse ata posedojnë lejen nga Ministria.
- 25.3. Pronari i automjetit me mbingarkesë nëse nuk posedon leje duhet të ringarkoj ngarkesën e tij në një automjet tjetër ose automjete tjera para se të lejohet ta vazhdoj udhëtimin.

Neni 26

- 26.1. Në hapësirën e përcaktuar për Brez mbrojtës rrugor askush nuk mund të hapë minierë, ndërtohen liqej artificial, fabrika dhe instalime të ngjajshme që mund t'i dëmtoj rrugët publike, brenda një distance prej:
- a) 60 metra nga rrugët magjistrale;
 - b) 40 metra nga rrugët regjionale; dhe
 - c) 30 metra nga rrugët lokale.

26.2. Në hapësirën e përcaktuar për Brez mbrojtës rrugor askush nuk mund të ndërtoj objekte, rezidenca, zyra, puse, gropa septike,transmetues elektrik dhe instalime të ngjajshme që mund të dëmtojnë rrugët publike brenda distancës prej:

- a) 20 metra nga rrugët magjistrale;dhe
- b) 10 metra nga rrugët regjionale dhe lokale.

Neni 27

Shfrytzimi i rrugës publike për nevoja publike të përgjithshme, si vënia e kablove të telekomunikacionit, gypave të ujit dhe lidhjeve ajrore dhe nëntoksore, duhet të jetë me pëlqimin dhe mbikëqyrjen e Ministrisë për rrugët magjistrale dhe regjionale, dhe në mbikëqyrjen e Komunës për rrugët lokale.

Neni 28

28.1. Personat juridik dhe fizik që dëshirojnë të shfrytzojnë ndonjë pjesë të rrugës magjistrale dhe regjionale, ose Brezit mbrojtës rrugor që korrespondon me rrugët magjistrale dhe regjionale për transport të jashtëzakonshëm, duhet të marrin leje të veçantë nga Ministria.

28.2. Ministria nxjerr rregulla mbi procedurën e lëshimit të lejeve për shfrytzimin e ndonjë pjese të rrugës magjistrale dhe regjionale dhe Brezit mbrojtës rrugor që korrespondon me rrugët magjistrale dhe regjionale nga personat juridik dhe fizik, siç parashihet në paragrafin 1 të këtij neni.

28.3. Ministria ka të drejtë të kërkoj dhe të përcaktoj rregulla për kompenzimin e pagesës-provizionit nga personat juridik dhe fizik për shfrytzimin e ndonjë pjese të rrugës magjistrale dhe regjionale dhe Brezit mbrojtës rrugor korresponduese me rrugët magjistrale dhe regjionale siç parashihet në paragrafin 1 të këtij neni.

28.4. Ministria nxjerr rregulla të veçanta mbi kompenzimin e pagesave nga personat juridik dhe fizik për shfrytzimin e pjesëve të caktuara të rrugës magjistrale dhe regjionale dhe Brezit mbrojtës rrugor që korrespondon me rrugët magjistrale dhe regjionale sipas paragrafit 2 të këtij neni.

Neni 29

29.1. Kur ndërtimi, struktura, instalimi, shenja ose çasja në rrugën e vendosur është ndërtuar në tokë në kundërshtim me këtë Ligj ose rregullat e kushtet e përmbajtura në leje, Ministria duhet të kërkoj nga pronari që ta lëvizë, largojë, ose ndryshojë ndërtimin,strukturën, instalimin, shenjën ose çasjen në rrugë.

29.2. Vërejtja sipas paragrafit 1 të këtij neni lëshohet në formë të shkruar dhe i dorzohet pronarit ose pronarëve personalisht.

29.3. Në raste kur sendet ose objektet e ndërtuara janë në pajtim me ligjin, pronari ka të drejtë në kompenzim sipas procedurës gjyqësore.

Neni 30

- 30.1. Shfrytëzimi i rrugëve publike mund të jetë lëndë e pagesës të shfrytëzuesit të caktuar, siç do të përcaktohet me rregulla të veçanta nga Ministria.
- 30.2. Tarifat e shfrytëzimit bazohen në distancën dhe kategorinë e automjetit.
- 30.3. Kategoritë e automjeteve dhe tarifat e zbatueshme për secilën kategori do të vendosen në një udhëzim administrativ që nxirret nga Ministria në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave

KREU VI INSPEKTIMI

Neni 31

- 31.1. Zbatimin e dispozitave të këtij ligji si dhe të akteve tjera nënligjore i mbikëqyrë Inspektorati i Ministrisë.
- 31.2. Ndërhyrjet në rrugë publike dhe në Brezin mbrojtës rrugor të tyre e mbikëqyrin inspektorët për ndërtim dhe urbanizëm në kuadër të kompetencave të tyre.

Neni 32

Inspektori për rrugë, ka kompetencë të mbikëqyrë mirëmbajtjen e të gjitha rrugëve publike, në suaza të përcaktuara me dispozitat unike të bazës profesionale për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve publike.

Neni 33

Nëse një apo më shumë Komuna themelojnë shërbimin për mbikëqyrje të rrugëve lokale, Ministria mund të autorizoj një inspektor për kryerjen e detyrave të punës të cilat kanë të bëjnë me bazat unike profesionale për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve lokale.

Neni 34.

Njësia ose personi juridik do të dënohet në një shumë nga 25 e deri në 2.500 Euro nëse ai:

- a) nuk ndërmerr masa të arsyeshme për të evituar dëmtimin e një personi ose pronës së një personi (neni 21);
- b) dëmton një rrugë publike, hudh materiale në një rrugë publike ose përndyshe bën ndërhyrje në një rrugë publike (neni 22);
- c) hyn në një rrugë publike që është mbyllur, pa marrjen paraprake të autorizimit (neni 23);

Neni 35.

Njësia juridike ose personi privat do të dënohet në një shumë nga 50 e deri në 5.000 Euro nëse ai:

- a) është pronar i një automjeti të mbingarkuar që lëviz në një rrugë publike pa leje të veçantë (neni 25);
- b) është pronar i një automjeti të mbingarkuar që lëviz në një rrugë publike në kundërshtim me kushtet e caktuara të lejes së veçantë (neni 25);
- c) bën transportim të veçantë pa leje të posaçme (neni 28)
- d) bën transportim të veçantë në kundërshtim me kushtet e lejes (neni 28)

Neni 36

Njësia ose personi juridik do të dënohet në një shumë nga 1.000 deri në 100.000 Euro nëse:

- a) ndërton një objekt brenda distancave të caktuara në nenin 26;
- b) vendosë kablo te telekomunikacionit, gypa uji ose struktura të ngjajshme pa pajtimin e Ministrisë ose Komunës (neni 27).

Neni 37

Të ardhurat e krijuara nga tarifat e mbledhura ose dënimet e vendosura sipas këtij ligji , derdhen në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës.

KREU VII

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 38

Procedurat e filluara sipas dispozitave Ligjit mbi rrugët ("Gazeta zyrtare e Kosovës"NR.43/74) do të përfundojnë sipas dispozitave ligjit të aplikueshëm.

Neni 39

Rrugët publike regjistrohen në libra mbi token, në harmoni me dispozitat që rregullojnë librat mbi token.

Neni 40

Ministria do të rregulloj bazat e të dhënave për rrugë publike dhe do të siguroj përpilimin e hartave me rrugë të vizatuara publike në masë përkatëse në afat prej një viti, nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 41

Në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji shfuqizohet Ligji mbi rrugët ("Gazeta zyrtare e Kosovës"nr.43/74).

Neni 42

Ministria për implementimin e dispozitave të këtij ligji nxjerr akte përkatëse nënligjore.

Neni 43

Ky ligj hyn në fuqi pasi që të miratohet nga Kuvendi dhe në ditën e shpalljes nga PSSP-ja

Ligji nr. 2003 / 11
29 Maj 2003

Kryetari i Kuvendit të Kosovës ,

Akademik Nexhat Daci